



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 23/2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, anëtarë, përkitazi me ankesën e z. Lutfi Hazirit, nga Lidhja Demokratike e Kosovës LDK-së, në seancën e mbajtur me 02.11. 2009, mori:

VENDIM

Pranohet Ankesa si e bazuar

Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është përgjegjës për shkeljen e Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” NR. 11/2009, neni 3.1 pika (a) për çka i shqiptohet gjoja në shumën prej 3.130 Euro, të cilën detyrohet të i paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, në Sekretariatit e KZAP-it për tu përcjellë në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

ARSYETIMI

Subjekti politik LDK ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se partia politike PDK, Më datë 20.10.2009, në Prizren ka bërë shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës, neni 33 shkronja (a) dhe nenin 31 shkronja (a) të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2009 dhe Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, duke mbuluar posterat e kandidatit për kryetar komune dhe anëtarëve kuvendit komunal të LDK-së për Prizren, me posterat e kandidatëve të PDK-së për anëtar të kuvendit komunal z.Rexhep Morina dhe z. Muhamet Krasniqi.

FAKTET

Më 21.10.2009 Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP) ka pranuar një ankesë nga z. Lutfi Haziri, kryetar i Shtabit Zgjedhor të LDK-së, duke pretenduar se partia politike PDK, më datë 20.10.2009, në Prizren, ka bërë shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës, neni 33 shkronja (a) dhe nenin 31 shkronja (a) të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2009 dhe Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, duke mbuluar posterat e kandidatit të LDK-së për kryetar komune dhe të kandidatëve të saj për anëtar të kuvendit komunal në Prizren, me posterat e kandidatëve të PDK-së për anëtar të kuvendit komunal z. Rexhep

Morina dhe z. Muhamet Krasniqi. Posterat janë mbuluar në rrugën “Remzi Ademaj”, “Rrasat e Koshares” dhe “Adem Jashari” në Prizren.

Për më tepër, KZAP-i ka pranuar disa fotografi nga vendi i ngjarjes ku shihen qartë posterat e mbuluar të kandidatëve të LDK-së me posterat e kandidatëve të PDK-së në Prizren.

KZAP informoi PDK-në me 22 Tetor 2009 rreth ankesës dhe i dha mundësi të përgjigjej bazuar në pajtim me nenin 4.3. të Rregullores së Punës të KZAP-it. KZAP-i mori përgjigje nga PDK-ja brenda afatit të caktuar. Për më tepër PDK-ja nuk i kishte pranuar KZAP-it se ishte përgjegjëse për mbulimin e posterave të kandidatëve LDK-së me ata të kandidatëve të PDK-së, por në vend të kësaj kishte deklaruar se shkelja ishte kryer nga “ndonjë subjekt tjetër politik, anëtar dhe mbështetës i subjektit tjetër politik, për të zbehur imazhin e sjelljes korrekte dhe ligjore të PDK-së”. Veç kësaj, PDK ka deklaruar se si ajo, ashtu edhe shtabi i saj zgjedhor i kanë bërë të gjitha përpjekje serioze për të parandaluar dhe dekurajuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e PDK-së nga shkeljet e pretenduara, mirëpo PDK-ja nuk ka bërë ndonjë përpjekje për të sqaruar në mënyrë specifike se si ishin implementuar këto përpjekje.

ANALIZA

Jurisdiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Rregulla Zgjedhore Nr. 11/2009, neni 3.1 parasheh Veprimet e ndaluar pika (a) parasheh:

3.1 pika (a) heqja, mbulimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër.

Rregulla Zgjedhore Nr. 11/2009, neni 2 parasheh:

- 2.3 Subjektet politike informojnë në mënyrë të duhur anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre rreth dispozitave të këtij Kodi.*
- 2.4 Subjektet politike ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të parandaluar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre nga shkelja e këtij Kodi.*
- 2.5 Subjektet politike mbahen përgjegjëse për shkeljen e këtij Kodi të kryera nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre;*

Është e qartë se Rregulla Zgjedhore Nr. 11/2009, neni 3.1 pika (a) dhe, neni 2.3, 2.4 dhe 2.5 zbatohet për Subjektet Politike. Është njësoj e qartë se në rastin në fjalë, ka

ndodhur një shkelje të këtyre dispozitave të lartcekura. Ndërsa nuk njihet identiteti i kryesit faktik të këtyre shkeljeve, dihet se PDK-ja është në kontroll të përgatitjes dhe shpërndarjes së materialeve të saj të fushatës.

PDK-së iu dha mundësia të jepte shpjegimet e saj për ngjarjen, gjë që e ka bërë më datë 28.10.2009. Prandaj, në përgjigjen nga PDK, kjo parti fajëson personat e paautorizuar, ky pohim nuk është njaft i bazuar, meqenëse PDK-ja ka nën kontroll përgatitjen dhe shpërndarjen e materialit për fushatën e vet. Kjo po ashtu nënkupton se, pllakatet e PDK-së nuk u janë lënë në dispozicion publikut të gjerë për qëllime të shpërndarjes. Prandaj është e arsyeshme të konkludohet se pllakatet e PDK-së në fjalë ishin vendosur nga njerëz që janë në një mënyrë të lidhur me PDK-në

Edhe sikur PDK të mos ishte vetë përgjegjëse për këto shkelje, duket se PDK nuk ka ushtruar përpjekje të arsyeshme për të mbikëqyrur shpërndarjen e materialeve të saj të fushatës. Gjithashtu, megjithëse KZAP-i dha mundësinë të shpjegonte se si i kishte marrë të gjitha masat për të qenë në pajtim me Rregullat Zgjedhore, ajo nuk ka dhënë këtë informacion. As nuk ka dhënë ndonjë informacion organizativ prej të cilit KZAP-i të konkludonte se shpërndarja e materialit ishte mbikëqyrur në mënyrën e duhur. Nga mungesa e një informacioni të tillë, KZAP-i arriti në përfundim se PDK ose nuk ka adaptuar ndonjë masë siç kërkohet sipas Rregullit Zgjedhor Nr. 13/2009, neni 3.6, ose ka adaptuar masa të pamjaftueshme.

Duke vendosur për gjobën që do të vihet në këtë lëndë, KZAP-i ka marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

1. Se shkelja në këtë rast ka të bëjë me postera dhe jo me stenda të mëdha afishimi apo objekte të ngjashme ekspozimi;
2. Se shkelja ka ndodhur në më shumë se një vend;
3. Se PDK ka marrë pjesë në zgjedhje të mëhershme;
4. Se PDK i është përgjigjur kërkesës së KZAP-it për të dhënë shpjegime lidhur me rrethanat.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 23/2009 më datën 02.11.2009.

